

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7814
E martë, 19 qershor 2024
Çmimi 0.50

Borrelli ua dorëzon vendeve të BE-së raportin për masat ndaj Kosovës | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUSH E PENGON PAQEN E QËNDRUESHME NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË? | FAQE 5



Dimitar Bechev nga Universiteti i Oksfordit pajtohet se Vuçiqi nuk ka gatishmëri për t'i çuar gjërat përpara, por thotë se një pjesë të përgjegjësishë e ka edhe Kurti. Vendimet e qeverisë së tij për t'i instaluar kryetarët shqiptarë në komunat me

shumicë serbe në veri, apo për ta ndaluar përdorimin e dinarit serb në Kosovë, nuk i kontribuojnë zgjidhjes së problemit, thotë Bechev. Ndërkaq Aidan Hehir nga Universiteti Westminster në Londër thotë se problemi

qëndron te Serbia. Ai thotë se ky vend prej vitesh udhëhiqet nga nacionalistë të linjës së ashpër, që kanë qenë pjesë e regjimit të Sllobodan Millosheviqit në vitet '90 dhe nuk duan paqe por, sipas tij, përkrahin idenë e krijimit të 'Serbisë së madhe'

PËRURORHET SKULPTURA E LEUTRIM AHMETIT, I VRARË GJATË LUFTËS NGA FORCAT SERBE | F. 5



KOSOVA DHE IZRAELI, MARRËVESHJE PËR HEQJEN E VIZAVE | F. 3



RAPORTOHET SE HUNGARIA DHE SLOVAKIA NUK DO TA KUNDËRSHTOJNË EMËRIMIN E RUTTES NË KRYE TË NATO-S | F. 2

PËRURORHEN INVESTIMET MBI 5 MILIONË EURO NË KLINIKËN E GJINEKOLOGJISË NË OKUK | F. 7

LANSOHET PROJEKTI E-TWINNING, MUNDËSOHET BASHKËPUNIMI ME SISTEMET ARSIMORE NË 40 SHTETE TË EVROPËS | F. 3

EKONOMI



ATK-ja THOTË SE TAKSITË DUHET TË PAJISEN ME SISTEM FISKAL TË VEÇANTË | F. 8

SHBA-ja SHQYRTON NJË KUADËR TË RI LIGJOR PËR MONEDHAT DIGJITALE | F. 8

SPORT



SOT TRI NDESHJE NË 'EURO 2024', SHQIPËRIA PËRBALLET ME KROACINË | F. 10

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Raportohet se Hungaria dhe Sllovakia nuk do ta kundërshtojnë emërimin e Ruttes në krye të NATO-s

AMSTERDAM, 18 QERSHOR - Mediet holandeze thonë se Hungaria ka hequr dorë nga kundërshtimi i saj që kryeministri holandez Mark Rutte të bëhet shef i ardhshëm i NATO-s pas takimeve në Bruksel. Presidenti i Sllovakisë, më herët më 18 qershor, gjithashtu sinjalizoi mbështetjen e mundshme të vendit të tij.

NATO po kërkon konsensus midis 32 vendeve anëtare që dikush ta pasojë norvegjezin Jens Stoltenberg në postin e shefit të aleancës, kur ai të largohet në muajin tetor.

Shtetet e Bashkuara, Britania, Franca, Gjermania dhe Turqia kanë thënë se do ta mbështesin kandidaturën e Ruttes.

Nëse konfirmohen raportimet se Hungaria dhe Sllovakia tani mbështesin kryeministrin holandez, Rumania do të mbetej pengesa e fundit.

Të gjithë 32 anëtarët e aleancës ushtarake duhet të miratojnë një kandidat për mandatin katërvjeçar.

RTL News më 18 qershor citoi burime të paidentifikuara të kenë thënë se Budapesti "nuk e kundërshton më kandidaturën [e Rutte]" pas një takimi midis Rutte dhe kryeministrin hungarez Viktor Orban në



margjinat e një samiti të liderëve të BE-së.

Zëdhënësi i kryeministrin hungarez Zoltan Kovacs konfirmoi në rrjetin social X se Orban dhe Rutte ishin takuar vonë më 17 qershor përpara samitit të BE-së për t'u fokusuar në "çështjet dypalëshe dhe ndërkombëtare".

Gazeta holandeze NOS citoi zëdhënësin e Orbanit të ketë thënë se kryeministri hungarez

dhe Rutte kishin një "bisedë të mirë".

Nuk ka pasur asnjë deklaram publik nga zyrtarët hungarezë për ndonjë ndryshim qëndrimi. Orban kishte thënë në fillim të këtij muaji se do t'i jepte fund kundërshtimit të tij ndaj kandidaturës së Ruttes në NATO, nëse do të kërkonte falje për kritikën e fundit ndaj qeverisë së tij në Budapest dhe do ta lejonte Hungarinë ta

përfundonte veten nga planet e ndihmës së aleancës ushtarake për Ukrainën.

Rutte tha më 17 qershor se ai mbeti "optimist i kujdesshëm për Hungarinë".

Më pas, më 18 qershor, presidenti i ri sllovak Peter Pellegrini tha se vendi i tij është i përgatitur ta mbështesë kryeministrin holandez për detyrën kryesore të NATO-s. "Pas një diskutimi

përfundimtar me Mark Rutte dhe konsultimit me qeverinë sllovake, Sllovakia mund ta mendojë Mark Rutte si shefin e NATO-s", tha Reuters duke cituar Pellegrinin.

Sllovakët janë ndër anëtarët më pro-rusë të BE-së dhe NATO-s dhe kryeministri populist i krahut të majtë, Robert Fico, ndaloi dërgesat e armëve në Ukrainë pas emërimit të tij në tetor.

Ashtu si Orban, edhe Fico ka kundërshtuar publikisht anëtarësimin përfundimtar të Ukrainës në NATO.

Orban ka qenë një kritik i vendosur i sanksioneve ndaj Rusisë dhe ndihmës së drejtpërdrejtë ushtarake për Kievin që kur filloi pushtimi rus i Ukrainës dy vjet më parë. Ai ka vazhduar vizitat dhe hapat e tjerë diplomatikë në Moskë pavarësisht prej thirrjeve të Perëndimit për unitet përballë kërcënimit rus.

Stoltenbergi udhëtoi në Hungari më 12 qershor dhe doli nga një takim me Orbanin duke thënë se Budapesti kishte rënë dakord të mos e bllokojë përkrahjen e aleancës për Ukrainën, por ka vendosur të mos ofrojë ushtarë apo fonde për ta ndihmuar vendin e rrënuar nga lufta.

Liderët e BE-së ende pa marrëveshje për postet kryesore

BRUKSEL, 18 QERSHOR - Liderët e Bashkimit Evropian (BE) nuk u pajtuan për emërimin e drejtuesve të rinj të institucioneve evropiane në takimin e tyre më 17 qershor.

Mungesa e marrëveshjes u konfirmua nga presidenti në largim i Këshillit Evropian, Charles Michel. "Është detyra jonë që deri në fund të qershorit të biem dakord për kandidatët për postet kryesore në BE dhe agjendën strategjike", tha Michel në fund të darkës së punës së liderëve evropianë.

Liderët u mblodhën mbrëmjen e së hënës në Bruksel, në përpjekjen e parë për të arritur një marrëveshje për emrat e rinj të krerëve të institucioneve të BE-së, Komisionit Evropian, Këshillit Evropian dhe emrin e ri në pozitën e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri.

Kandidatura e shefes së deritashme të BE-së, Ursula von der Leyen, është e sigurt, por tani liderët e bllokut janë në kërkim të emrave të rinj për pozitën që kanë mbajtur Charles Michel dhe Josep Borrell.

Emrat që kanë shanset më të mëdha për këto poste, sipas



informacioneve jozyrtare, është ai i ish-kryeministrin të Portugalisë, Antonio Costa, për pozitën e presidentit të Këshillit Evropian dhe ai i kryeministres së Estonisë, Kaja Kallas, për pozitën e kryediplomates së BE-së.

Ky ishte takimi i parë i liderëve evropianë, pas zgjedhjeve të mbajtura në vendet anëtare të BE-së, më 6-9 qershor dhe mendohej se do të ishte ndër

samitet më të lehta të BE-së.

Krerët e shteteve dhe qeverive duhet të ishin pajtuar në parim për emrat për të cilët tashmë kishte një marrëveshje joformale.

Gjithçka ndryshoi kur liderët e atyre vendeve apo qeverive që vijnë nga blloku popullor evropian kërkuan një pjesë në postin e presidentit të Këshillit Evropian.

Presidenti i Këshillit Evropian

zgjidhet nga liderët e BE-së për një periudhë dy vjet e gjysmë dhe mandati mund të rinovohet vetëm një herë.

Roli i presidentit të Këshillit Evropian është t'i kryesojë takimet në nivel të liderëve të BE-së dhe ta përmirësojë punën e Këshillit Evropian.

Që kur ekziston institucioni i presidentit të Këshillit Evropian, secili prej tyre ka kaluar dy mandate të plota prej pesë vitesh

në krye të institucionit.

Sipas disa burimeve nga takimi, Partia Popullore Evropiane ka kërkuar që mandati i presidentit të Këshillit Evropian të ndahet në dy pjesë nga dy vjet e gjysmë, ku Partia Popullore do të merrte një nga mandatet.

Kjo dukej se ishte pengesa kryesore dhe ishte arsyeja pse drejtuesit nuk u pajtuan.

Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri ka rol të dyfishtë.

Zyrtari që mban këtë pozitë është një prej nënkryetarëve të Komisionit Evropian dhe ka rolin e kreut të diplomacisë evropiane. Ky person menaxhon politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Ai, gjithashtu, punon për të krijuar konsensus midis vendeve anëtare të BE-së dhe prioritetëve të tyre përkatëse, duke përfshirë kryesimin e takimeve midis ministrave të jashtëm të BE-së, ministrave të mbrojtjes, ministrave të tregtisë dhe zhvillimit.

Liderët do t'i vazhdojnë diskutimet në fund të javës së ardhshme kur do të mbahet samiti i rregullt i BE-së, më 27 dhe 28 qershor.

Kurti tha se do t'i fitojnë zgjedhjet lokale e qendrore, deputetja e LDK-së: Lojë e dështuar e kryeministrit të dorëzuar

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Deputetja e Lidhjes Demokratike e Kosovës, Hykmete Bajrami, i ka reaguar kryeministrit Albin Kurti, pas deklaratës se do t'i fitojnë zgjedhjet lokale dhe nacionale.

Bajrami në "Facebook" ka shkruar se kjo është një lojë e dështuar e kryeministrit të dorëzuar. "Loja e dështuar e

kryeministrit të dorëzuar. Asnjë banesë për çiftet e reja. Asnjë rrugë e përfunduar. Me dy-tri çerdhe të nisura e 160 të premtuara. Me shtrenjtim të rrymës. Me dështime të njëpasnjëshme në arsim e shëndetësi. Me asnjë rezultat në ekonomi. Me tender njëburimor për çdo ditë. Tash partia në pushtet

është në panik sepse i dështoi nisma për ta instrumentalizuar dhe nënshtruar opozitën me zgjedhje e duke u shitur viktimë. Në zgjedhje do të shkojmë duke të kërkuar llogari për mashtrimet dhe propagandën dhe jo duke mashtruar se nuk iu la opozita të punoni", ka shkruar deputetja Bajrami



Kosova dhe Izraeli, marrëveshje për heqjen e vizave



PRISHTINË, 18 QERSHOR - Izraeli i ka hequr vizat për qytetarët e Kosovës, duke u bërë kështu shteti i 50-të që mundëson lëvizje të lirë për kosovarët.

Nënshkrimi i marrëveshjes në mes të dy shteteve u bë të martën në Prishtinë nga ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, dhe ministri i Brendshëm i Izraelit, Moshe Arbel.

Më herët gjatë ditës, Arbel është pritur në takim nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

Dy shtetet zyrtarizuan

marrëdhëniet diplomatike në shkurt të vitit 2021.

Atyre iu parapriu ajo që njihet si Marrëveshja e Uashingtonit, të cilën Kosova dhe Serbia e nënshkruan më 4 shtator të vitit 2020, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve ekonomike.

Kosova hapi ambasadën e saj në Jerusalem në korrik të vitit 2021 në këmbim të njohjes së pavarësisë së saj nga Izraeli.

Izraeli është vendi i fundit që e njohu pavarësinë e Kosovës.

Nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike, Kosova shënoi edhe

ritje të shkëmbimeve tregtare.

Në vitin 2022 vlera e importeve nga ky shtet arriti në 42 milionë euro - prej 22 milionë sa ishte në vitin 2020 kur dy vendet nuk kishin lidhje diplomatike.

Ngjashëm ndodhi edhe me eksportet, nga 85 000 euro në vitin 2020, ato u rritën në 783 000 euro më 2022, sipas të Dhënave të Doganave të Kosovës.

Kosova importon nga Izraeli kryesisht lëndë djegëse dhe produkte të plastikës, ndërsa eksporton kryesisht produkte të tekstilit.

Njoftimin se Izraeli është pajtuar t'i heqë vizat për kosovarët e kishte bërë në fillim të këtij viti presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani.

Prej 1 janarit, shtetasit e Kosovës me pasaporta biometrike udhëtojnë lirshëm në shtetet e zonës Shengen në Evropë.

Ndërkaq më 5 janar u bë me dije se ata mund ta vizitojnë edhe Spanjën, pas një njoftimi nga Departamenti për Migrim dhe Çështje të Brendshme i Komisionit Evropian, se Spanja njih tashmë pasaportën e zakonshme të Kosovës.

Liberalizimi i vizave u mundëson qytetarëve të Kosovës, që kanë pasaporta biometrike, të qëndrojnë deri në 90 ditë brenda gjashtë muajsh në cilindo nga 27 shtetet anëtare të zonës Schengen. Udhëtimet pa viza shërbejnë për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme. Megjithatë, liberalizimi i vizave nuk nënkupton leje pune apo përfitime të tjera. Aktualisht janë 107 shtete që vazhdojnë të kërkojnë viza për vizita nga Kosova, ndërsa 39 vende mundësojnë viza në mbërritje për qytetarët e Kosovës.

Lansohet projekti e-Twinning, mundësohet bashkëpunimi me sistemet arsimore në 40 shtete të Evropës

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, dhe përfaqësuesi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Johannes Madsen, kanë bërë lansimin e projektit e-Twinning, që i mundëson sistemit arsimor në Kosovë të bashkëpunojë me sistemet arsimore në 40 shtete të Evropës.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit,

Arbërie Nagavci, ka theksuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi, duke thënë se përmes këtij projekti bëhet promovimi i mësimit të bazuar në projekte dhe qytetarinë digjitale, duke mundësuar të zhvillohen aftësitë digjitale në gjeneratat e reja. "Jemi bashkë për ta lansuar zyrtarisht projektin e-Twinning, pasi që këtë vit i jemi bashkuar komunitetit të e-Twinning, platformë kjo online që mundëson bashkëpunimin e

mësuesve, nxënësve dhe stafit të shkollave nga vende të ndryshme dhe Kosova për herë të parë po bëhet pjesë e platformës me më shumë se 40 shtete të cilat tashmë kanë qasje he mundësi të bashkëpunimit. Kjo është bërë e mundur përmes bashkëpunimit të MASHTI-t si bashkfinancuese me Komisionin Evropian duke ofruar mundësi për bashkëpunim me shkollat e 40 shteteve", ka deklaruar Nagavci.





Kush e pengon paqen e qëndrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë?

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ishte prilli i vitit 2013 kur Bashkimi Evropian bëri me dije se Kosova dhe Serbia kanë arritur "marrëveshje historike" për normalizimin e marrëdhënieve.

Marrëveshja - e para e atij lloji mes tyre që nga përfundimi i luftës më 1999 - u nënshkrua nga kryeministrat e atëhershëm të dy vendeve, Hashim Thaçi dhe Ivica Dačić. "Ky është një hap më larg së kaluarës për të dy dhe një hap më afër Evropës", tha shefja e atëhershme e politikës së jashtme të BE-së, Catherine Ashton, e cila i ndërmjetësonte bisedimet mes tyre.

Nga ajo kohë, Serbia vetëm hapi disa kapituj negociatash për praninë në BE, ndërsa Kosova vetëm aplikoi për anëtarësimin në këtë bllok.

Shumë pika të marrëveshjes nuk u zbatuan dhe tensionet vazhduan. Në disa raste kulmuan edhe në protesta e barrikada në veri të Kosovës, ku popullata shumicë është serbe dhe, e ndikuar nga Serbia, kundërshton autoritetin e Kosovës.

Dhjetë vjet pas marrëveshjes së parë, më 2023, dy vendet u dakorduan edhe për një tjetër - njësoj për normalizimin e marrëdhënieve. Edhe atëherë u cilësua si "arritje e rëndësishme" nga Bashkimi Evropian.

Duke iu referuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vučić, shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, tha se ata janë pajtuar që t'i zbatojnë të gjitha nenet e marrëveshjes dhe detyrimet përkatëse.

Më shumë se një vit më vonë, gati të gjitha këto nene mbeten vetëm në letër. Tensionet kulmuan sërish me protesta të dhunshme në veri, madje edhe me incidente të armatosura.

Për Kurtin, fajtor është Vučić, për

Vučićin është Kurti. Për Kurtin, Serbia është rrezik për Kosovën. Për Vučićin, qeveria e Kurtit është rrezik për serbët e Kosovës.

Në një samit javën e kaluar, për nder të 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës, Kurti tha se qeveria e tij nuk e ka asnjë problem me serbët e vendit. "Problemin e kemi me Beogradin, i cili nuk u distancau as nga Millosheviqi i së kaluarës e as nga Putini i së tashmes", tha Kurti duke iu referuar ish-presidentit jugosllav dhe presidentit aktual rus. Vetëm tri ditë para ngjarjes ku foli Kurti, Qeveria e Serbisë dhe ajo e Republikës Sërpska në Bosnjë-Hercegovinë miratuan një deklaratë të përbashkët, e cila, mes të tjerash, Kosovën e trajton si "pjesë të patjetërsueshme të Serbisë". Formulimin e tillë, Serbia vazhdon ta ketë edhe në Kushtetutë, përkundër faktit se Kosova është shtet i pavarur prej saj qysh në vitin 2008.

Radio Evropa e Lirë iu drejtua edhe Qeverisë së Kosovës, edhe Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, për t'i pyetur se nga çka ose prej kujt varet paqja e qëndrueshme mes dy vendeve, por asnjëri prej institucioneve nuk u përgjigj.

Aidan Hehir nga Universiteti Westminster në Londër thotë se problemi qëndron te Serbia. Duke folur për programin Expose të Radios Evropa e Lirë, ai thotë se ky vend, prej vitesh, udhëhiqet nga nacionalistë të linjës së ashpër, që kanë qenë pjesë e regjimit të Slobodan Millosheviqit në vitet '90 dhe nuk duan paqe - përkrahin, sipas tij, idenë e krijimit të 'Serbisë së madhe'. "Është e pamundur për Kosovën të bëjë marrëveshje me një vend që nuk e pranon të drejtën e saj për të ekzistuar, që vazhdon të ndërhyjë në punët e saj të brendshme dhe që ndez trazira të dhunshme brenda territorit të saj. Pra, faji është te Serbia, jo te Kosova. Kosova është shtet i pavarur. Nuk e

kërcënon askënd, nuk do të pushtojë askënd dhe nuk do ta marrë tokën e askujt", thotë Hehir. Dimitar Bechev nga Universiteti i Oksfordit pajtohet se Vučići nuk ka gatishmëri për t'i çuar gjërat përpara, por thotë se një pjesë të përgjegjësive e ndan edhe Kurti. Vendimet e qeverisë së tij për t'i instaluar kryetarët shqiptarë në komunat me shumicë serbe në veri, apo për ta ndaluar përdorimin e dinarit serb në Kosovë, nuk i kontribuojnë zgjidhjes së problemit, thotë Bechev. "Dhe, unë nuk mendoj se ka presion kohor për zgjidhje. Sepse, për aq kohë sa ka tensione, Vučići ka rrefime të mira për t'ua thënë zgjedhësve të tij... se ai po ngrihet për serbët, se ai po i mbron interesat e Serbisë etj. Ngjashëm edhe Albin Kurti luan me zgjedhësit e tij, që përfshijnë shumë nacionalistë", thotë Bechev për Exposeden.

Kjo status quo, sipas tij, mund të vazhdojë për kohë të pacaktuar dhe një pjesë të përgjegjësive ia hedh edhe BE-së për, siç thotë, "ofertat abstrakte" për integrimin e dy vendeve në radhët e veta. Ai shton se BE-ja duhet ta përdorë strategjinë e "karotës dhe shkopit" me to - t'u ofrojë një gjë në këmbim të një gjëje. BE-ja e ka bërë të qartë si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë se integrimi i tyre në familjen evropiane do të varet nga normalizimi i marrëdhënieve me njëra-tjetrën. Ajo vazhdimisht u përçon mesazhe palëve për t'i zbatuar marrëveshjet e arritura.

Por, Bechev pret që vëmendja e BE-së tani, kur është në proces të zgjedhjes së udhëheqësve të saj të rinj, të mos jetë as te Kosova, as te Serbia. Për më tepër, ai thotë se dinamikat mund të ndryshojnë krejtësisht nëse në zgjedhjet presidenciale në ShBA zgjidhet Donald Trump, i cili në mandatin e parë ka anuar nga zgjidhjet më të shpejta dhe më të prera. "Nëse

Trumpi i fiton zgjedhjet, politika mund të zhvendoset te gjetja e një zgjidhjeje me ndarjen [e Kosovës]. Edhe këto zhvillime pastaj do ta zgjasnin problemin", thotë Bechev. Ndarja apo korrigjimi i kufijve është përmendur si opsion në vitin 2018 edhe nga vetë udhëheqësit e atëhershëm të Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vučić, por ideja është heshtur, pas kundërshtimeve që ka hasur në të dyja vendet.

Hehir nga Univeriteti Westminster thotë se nëse do të ketë ndonjëherë paqe të qëndrueshme në Ballkan, ajo duhet të vijë nga qeveri që pranojnë se kufijtë aktualë nuk mund të ndryshohen.

Hehir thotë se Perëndimi duhet t'i trajtojë Kosovën dhe Serbinë si shtete të barabarta dhe nëse do zgjidhje mes tyre, trysinë ta përqendrojë te Serbia, e cila, me mbështetjen e Rusisë, ka më shumë leva në duar për të manipuluar. "Serbia është e rrethuar nga Bashkimi Evropian dhe NATO-ja, andaj është shumë e ndjeshme ndaj sanksioneve perëndimore. Perëndimi mund të marrë një qëndrim më të ashpër ndaj Serbisë dhe t'i kërkojë asaj jo domosdoshmërisht ta njohë Kosovën, por së paku ta ndalojë ndërhyrjen në punët e brendshme të saj dhe ta lejojë anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare. Pra, Perëndimi mund ta bëjë këtë", thotë Hehir.

Qytetarët që, sipas Bechevit, "janë gjithmonë peng i situatave të tilla pezull, ose shndërrohen në top futbollit mes dy qeverive", janë optimistë të rezervuar për paqen e qëndrueshme me vendin e tjetrit. "Unë personalisht besoj se po [mund të ketë paqe] por do të duhet një kohë më e gjatë. Unë si gjeneratë e re, edhe pse nuk e kam përjetuar luftën, jam rritur me frymën e urrejtjes ndaj Serbisë, dhe

besoj se duhet kohë", thotë Gentiana Fejza, në fillimin e të 20-tave.

Bashkëqytetari i saj nga Prishtina, Orhan Avdiu, thotë se "me këtë regjim në Serbi nuk mund të arrihet paqe". "Është një klasë politike nga koha e Millosheviqit. Në pushtet janë njerëz të tij dhe nuk mund të ketë marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. "Duhet të kalojë kohë. Serbia ka qasje shumë dekonstruktive dhe do të duhet kohë shumë e gjatë", thotë Majlinda Ferati.

Në Beograd, një qytetare që dëshoi të identifikohet vetëm me emrin e saj Jellena, thotë se nuk beson në paqe të qëndrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Konflikti ka histori të gjatë. Ka edhe shumë njerëz që janë nacionalistë. Nacionalizmi këtu është më i fuqishëm se gjithçka", sipas saj.

"Është një pyetje e vështirë. Shumë njerëz janë vrarë dhe tani familjarët e kanë vështirë ta shtrijnë dorën. Duhet shikuar gjërat pozitive, por politika helmon gjithçka, në të gjitha anët", thotë Ivo Beserovac.

Stefan Vukashinoviç mendon se "varet nga gjeneratat". "Sa më të reja që janë, sa më të pranishme në internet, e shohin që mund të arrihet paqe", thotë ai.

Se kur do të mund të shihen udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë sërish në tryezën e bisedimeve - së paku për të bërë përpjekje për të arritur paqe - nuk dihet.

Gjasat janë të vogla gjatë muajve të verës, derisa të zgjidhen pasardhësit e ndërmjetësuesve aktualë. ShBA-ja dhe Gjermania përsërisin se dy vendet duhet të shkojnë drejt njohjes reciproke.

Me fjalët e ambasadorit amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier - "asgjë më pak nuk e përmbush vizionin e një Evrope të plotë, të lirë, të begatshme dhe në paqe".

Borrelli ua dorëzon vendeve të BE-së raportin për masat ndaj Kosovës

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ua ka dorëzuar vendeve anëtare të BE-së raportin lidhur me masat që i janë vënë Kosovës më shumë se një vit më parë, ka konfirmuar zëdhënësi i bllokut, Peter Stano. Në raport është bërë vlerësimi nëse duhen hequr masat ndaj Kosovës, të vëna për shkak të tensionimit të situatës në veri të vendit, në maj dhe qershor të vitit 2023.

Atëbotë BE-ja pati thënë se Kosova nuk ka bërë mjaftueshëm për shtensionim të situatës. Megjithatë, nuk dihet nëse Borrelli ka rekomanduar heqjen e masave. Diskutimi i parë rreth këtij raporti do të mbahet të mërkurën në nivel të ambasadorëve të vendeve anëtare të BE-së. Megjithatë, në atë takim nuk pritet të merret një vendim se si të veprohet për masat.

Dorëzimi i këtij raporti, qoftë edhe

me rekomandim të qartë, nuk do të thotë se masat hiqen menjëherë.

Ky raport vetëm do t'u shërbejë vendeve anëtare për ta rikthyer këtë çështje në agjendë dhe për ta filluar shqyrtimin e mundësisë së heqjes së masave në të ardhmen. Ndonëse ka kaluar një vit, pak dihet se kush saktësisht është prekur prej këtyre masave. Zyrtarët kanë thënë publikisht se janë pezulluar takimet mes zyrtarëve evropianë dhe atyre të Kosovës, janë pezulluar disa takime në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit dhe janë pezulluar dhe janë ndaluar prokurimet e reja të projekteve që burojnë nga IPA 2023 [Instrumentet e Para-Anëtarësimit] dhe nuk kanë filluar diskutimet për IPA 2024.

Zyrtarë të BE-së kanë diskutuar për herë të parë rreth mundësisë së heqjes së masave në prill të këtij viti, andaj edhe kanë kërkuar një



raport prej Borrellit.

Dorëzimi i raportit është shtyrë disa herë.

Si një prej arsyeve për shtyrje është përmendur aksioni i Policisë së Kosovës në veri të vendit për mbyllje të degëve të Bankës

Kursimore të Postës së Serbisë, por edhe kundërshtimet e ndryshme të disa zyrtarëve të Komisionit Evropian.

Disa burime diplomatike i patën thënë Radios Evropa e Lirë atë muaj se shumica e vendeve të

bllokut kanë qenë në favor të heqjes së masave kufizuese për Kosovën.

Dallimi i vetëm mes vendeve anëtare ka qenë nëse masat duhet të hiqen menjëherë apo gradualisht.

Përrurohet skulptura e Leutrim Ahmetit, i vrarë gjatë luftës nga forcat serbe

SKENDERAJ, 18 QERSHOR - Në 25-vjetorin e çlirimit të Skenderajt është përruroar skulptura e Leutrim Ahmetit, shtatëvjeçarit të vrarë gjatë luftës së fundit në Kosovë nga forcat serbe.

Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka thënë se, krahas shtatores së kryekomandantit legjendar Adem Jashari, sheshi i këtij qyteti do ta mbajë edhe shtatoren e Leutrim Ahmetit shtatëvjeçar që përfaqëson çdo viktimë të vrarë në luftën e Kosovës. "Në këtë datë në shënojmë dy momente të rëndësishme: Ditën e Çlirimit të Skenderajt dhe Ditën e Përkujtimit të Dëshmorëve dhe Martirëve të komunës sonë. Pa mbështetjen e shteteve mike, Kosovës vështirë do t'i vinte liria që ka pritur me shekuj. Kjo pjesë e sheshit të qytetit tonë nga sot do të personifikohet nga dy figura që u bënë të njohura me historinë e tyre: nga Adem Jashari që personifikon trimërinë dhe guximin e trimave të UÇK-së duke dhënë jetën në shërbim të



lirisë së popullit shqiptar për liri dhe nga Leutrim Ahmeti që përfaqëson çdo viktimë të vrarë në luftën e Kosovës. Pyetja e vetme që shtrohet me adresën e është se çfarë faji pati Leotrimi?

Ai si 7-vjeçar në qendër të Skenderajt do të na ligjërojë mbi konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve", ka thënë ai. Profesor Nusret Pllana fjalimin e filloi duke i përshëndetur të

pranishmit me fjalinë e tij të njohur: "Ju flet Kosova e lirë". Ai pati kritika për zyrtarët qeveritarë pasi nuk kanë ngritur një obelisk për t'i përkujtuar të gjithë fëmijët e vrarë gjatë luftës.

"Drenica djep dhe buka e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, andaj jorastësisht krimet e para kundër popullit shqiptar janë bërë në Qirez, Likoshan dhe Prekaz. Qëndresa ishte buka dhe uji i çdo qytetari i kësaj treve heroike. Askujt tjetër nuk i ka hije 25-vjetori i çlirimit sesa Drenicës", ka thënë ai.

Në emër të familjes Ahmeti foli Milaimi, i cili kërkoi që të ndërtohet një obelisk që përkujton të gjithë fëmijët e vrarë. Ai nuk la pa përmendur edhe ish-krerët e UÇK-së në Hagë. "Dhembjes së Leotrimin sot i shtohet edhe më shumë mungesa e çlirimtarëve, e bashkëluftëtarëve të Malushit (babait të tij) që po mbahen padrejtësisht në Hagë. Sa e sa Leotrima të tjerë anembanë Kosovës ranë që ne sot të gëzojmë e festojmë me dhimbje e krenari. Sot Leotrimi po kthehet në qytetin e tij të lindjes si një shembull i ndërgjegjes botërore të dhimbjes shekullore të shqiptarëve", u shpreh ai.

Bardhyl Mahmuti shpallet "Qytetar Nderi" i Skenderajt

SKENDERAJ, 18 QERSHOR (ER) - Veprimtari i shquar i çështjes kombëtare dhe ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Bardhyl Mahmuti, është shpallur "Qytetar Nderi" i komunës së Skenderajt.

Ky titull Bardhyl Mahmutit i është dhënë nga Kuvendi Komunal i Skenderajt me rastin

e 25-vjetorit të çlirimit të kësaj komune.

Në seancën solemne në nderim të veprimtarit Mahmuti kanë marrë pjesë kryetari dhe nënkryetari i Skenderajt, Fadil Nura dhe Sami Lushtaku.

Titulli "Qytetar Nderi" i Skenderajt, Bardhyl Mahmuti i është dhënë për kontributin e tij

si një ndër themeluesit e UÇK-së dhe për kontributin e tij në dokumentimin gjenocidit të Serbisë në Kosovë.

Bardhyl Muahmuti është themelues i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur". Ai ka botuar disa libra në të cilat pasqyrohen krimet dhe gjenocidi i Serbisë në Kosovë.



Bashkatdhetari Shaban Krasniqi i dhuroi autoambulancë QKMF-së në Podujevë

PODUJEVË, 18 QERSHOR - Bashkatdhetari Shaban Krasniqi i cili jeton dhe punon në Suedi, të martën i ka dhuruar një autoambulancë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në

Podujevë. Kryetari Bulliqi e priti në takim dhe e falënderoi Krasniqin për donacionin, për të cilën tha se do të shërbejë në ofrimin e shërbimeve dhe ndihmës së shpejtë

shëndetësore për pacientët. Bulliqi pranimin e këtij donacioni e ka bërë bashkë me drejtoreshën e Shëndetësisë, Adelina Stublla dhe stafin menaxherial të QKMF-së.



25 vjet nga çlirimi i Kamenicës, nderohen dëshmorët



festojmë dhe sot shënojmë këtë ditë me aktivitete të shumta, na takon neve dhe brezave që vijnë pas nesh që të vazhdojnë me punë e përpjekje, në mënyrë që ta kuptojnë që dashuria ndaj vendit duhet të jetë e pashtershme si dhe kontributi gjithashtu. Në këtë ditë ne duhet ta kujtojmë kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët dhanë jetën e tyre për vend të lirë. E sot ne i nderojmë edhe dëshmorët dhe luftëtarët nga Kamenica, pra sot është dita e tyre e festa jonë. Lavdi të gjithë dëshmorëve të lirisë! Gëzuar Ditën e Çlirimit Kamenicë", ka thënë kryetari Rahimaj. Edhe përfaqësuesi i OVL-UÇK-së, dega në Kamenicë, Milaim Limoni në këtë ditë ka përkujtuar veprën dhe jetën e dëshmorëve të rënë. "Sot është dita më e rëndësishme e komunës sonë, dita e lavdisë, e sakrificës, e kontributit, e lirisë, e gëzimit. Po e festojmë këtë ditë të krenarisë sonë, por këtë ditë nuk do të mund ta festonim pa gjakun e derdhur të dëshmorëve tanë, të heronjve tanë, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky 18 qershor është sinonim i veprës dhe sakrificës për të gjithë të rënë për liri. Lavdi veprës së tyre e gëzuar Ditën e Çlirimit Kamenicë!", ka thënë ai. Pas seancës solemne, kryetari Rahimaj së bashku me nënkryetarin Jakupi, kryesuesin e Kuvendit Kastrati, drejtorë komunalë, asamblistë dhe të tjerë, kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve të rënë për liri.

KAMENICË, 18 QERSHOR - Kuvendi Komunal i Kamenicës ka mbajtur të martën mbledhje solemne për nder të 25-vjetorit të çlirimit të Kamenicës. Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Liridon Kastrati, në këtë mbledhje ka thënë se komuna e Kamenicës sot me plot krenari po e shënon Ditën e Çlirimit.

"Pas shumë vuajtjeve e sakrificave, 25 vjet më parë u kthye shpresa për jetë, falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, posaçërisht familjes Jashari. Kjo ditë është festë për ne, por edhe ditë që bën të reflektojmë për të ardhmen, për brezat e rinj, për një të ardhme sa më të mirë për ta. 18 Qershorin - Ditën e Lirisë -

e solli sakrificat e të gjithë atyre që dhanë jetën për liri. Lavdi për të gjithë dëshmorët e kombit!", ka thënë ai. I pari i komunës, Kadri Rahimaj, duke kujtuar të rënë që dhanë jetën për këtë ditë, ka thënë se kjo ditë, që është shndërruar në një ditë kremte, sjellë në memorie sakrificën që është bërë për liri.

"Kjo ditë na përkujton që puna jonë duhet të vazhdojë për t'i shpërblyer ata që dhanë jetën për liri të vendit. Kujtojmë me krenari ata heronj që u ngritën kundër shtypjes që vendi ynë të jetë i lirë. Për këtë ne jemi përgjegjës të mbajmë të gjallë kujtimin e tyre dhe t'ua japim vlerën idealeve të tyre për vendin e lirë. Ndërsa

Mbahet koncert kulturor-artistik për Ditën e Çlirimit të Gjilanit

GJILAN, 18 QERSHOR - Për nder të Ditës së Çlirimit të Gjilanit, në kuadër të aktiviteteve është mbajtur edhe koncerti kulturor-artistik nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Gjilani", në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Nën kryetarja e komunës së Gjilanit, Leonora Morina-

Bunjaku, ka folur në emër të kryetarit Alban Hyseni. Po ashtu, ishte edhe drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Kushtrim Zeqiri, e zyrtarë të tjerë. Pjesëmarrës ishin edhe ansamblet "Bajram Shabani" nga Kumanova, ai "Anamorava" nga Vitia. Po ashtu, u bë edhe parakalimi

i të rinjve dhe të rejave me veshje kombëtare nëpër qytetin e Gjilanit. Për kontributin e dhënë në fushën e artit e kulturës është ndarë mirënjohje për kryetarin e komunës Alban Hyseni për drejtorin e Kulturës dhe Sportit Rinor, Kushtrim Zeqiri, e të tjerëve.



Asfaltohet rruga në fshatin Malësi e Re të Prizrenit

Prizren, 18 qershor - Në vazhden e punimeve në gjithë territorin e komunës së Prizrenit, pas

ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore dhe trotuareve, është asfaltuar rruga (710 metra)

në afërsi të fabrikës "Kamila Chocolate" në fshatin Malësi e Re, që ka qenë një

domosdoshmëri për lehtësimin e lëvizjes së makinave dhe këmbësorëve në këtë zonë.



Kosova ia dorëzon Serbisë mbetjet e tre trupave të vrarë gjatë luftës

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Mbetjet e tre trupave të qytetarëve serbë të vrarë në luftën e fundit në Kosovë u janë dorëzuar autoriteteve të Serbisë të martën në pikën kufitare në Merdar. Siç u raportua, bëhet fjalë për trupat e Svetislav Xhapos, Perka Mlladenoviqit dhe Momir Millenkoviqit.

Deri sot trupat e tyre janë mbajtur bashkë me 280 mbetje të tjera të paidentifikuara në morgun e Prishtinës.

Ditor Haliti, drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, ka thënë për Radion Evropa e Lirë se mbetjet e trupave që u dorëzuan sot janë mbajtur në Institut që nga paslufta, por ka pasur probleme për identifikimin e tyre. "Kanë qenë në Institut, sepse nuk kanë mundur të identifikohen gjatë kësaj kohe për arsye se familjarët nuk kanë dhënë mostra të gjakut që të mund të identifikohen. Vitin e kaluar janë dhënë mostrat e gjakut të familjarëve dhe janë dërguar mostra shtesë të ADN-së, të cilat na kanë dhënë rezultatet e atyre që janë të identifikuar", ka thënë ai.

Për pranimin e këtyre trupave kanë njoftuar edhe autoritetet e Serbisë. Sipas Qeverisë në Beograd, ata janë vrarë në Ferizaj, Prizren dhe Prishtinë në vitin 1999.

Lilana Millenkoviq, bashkëshortja e Momir Millenkoviqit, tha në Merdar se ai ishte kidnapuar më 29 gusht 1999 në Prizren, ku kishte shkuar për ta vizituar shtëpinë. Që atëherë tha se nuk ka ditur asgjë për të. "Falë Zotit që



e gjetëm, të paktën të dimë ku është varri, ku ta ndezim qiriun. Deri më tani gjithçka ka qenë e paqartë", tha ajo.

Kryetari i Komisionit të Serbisë për Persona të Zhdukur, Velko Odaloviq, në Merdar tha se ka ende shumë punë për të bërë para zbardhjes së fatit të të gjithë personave të zhdukur. "Ne duam t'i qasemi këtij problemi pa dallime, të veprojmë sipas kërkesave të palës prishtinase dhe familjeve të shqiptarëve, por duam që ata të kenë të njëjtin qëndrim ndaj kërkesave tona dhe kërkesave të familjeve tona".

Kosova disa herë e ka akuzuar Serbinë se po vazhdon ta shkelë

marrëveshjen për personat e pagjetur të arritur në Bruksel ndërmjet dy vendeve, duke i shpërfillur kërkesat e Kosovës për hapjen e arkivave të policisë dhe ushtrisë serbe në lidhje me mijëra personat e zhdukur me forcë gjatë luftës së viteve 1998/1999 në Kosovë.

Për t'i shtuar përpjekjet në këtë drejtim, Kosova dhe Serbia, një vit më parë, u pajtuan për Deklaratën e përbashkët për personat e zhdukur, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Zotimet që u bënë me këtë deklaratë përfshijnë: qasje të

plotë në informacione të besueshme, mes tyre edhe ato me status të klasifikuar; vënie në dispozicion të të gjitha dokumenteve me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur, si dhe punë të përbashkët përmes një komisioni të kryesuar nga Bashkimi Evropian.

Një vit pas, asgjë prej këtyre nuk është realizuar në praktikë, të gjitha kanë mbetur vetëm në letër.

Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, Ditor Haliti, ka thënë se në këtë Institut ka ende shumë mbetje mortore të paidentifikuara. "I kemi 280 trupa

(mbetje kockore) që nuk kanë përputhje me mostrat e gjakut, janë të dy komuniteteve, serbë dhe shqiptarë. Po punohet edhe në rrafshin e zhvarrimeve që janë bërë vitin e kaluar, por edhe rishikimin e mbetjeve mortore që janë", ka thënë ai.

Haliti, po ashtu, ka bërë me dije se institucionet e Kosovës, Policia e Kosovës, misioni i EULEX-it e Komisioni Qeveritar për të Pagjeturit janë duke i vazhduar kërkimet për mbetje mortore, por nuk ka dhënë hollësi të tjera.

Gjatë luftës së viteve 1998/'99 në Kosovë u vranë rreth 13 000 njerëz, 10 794 shqiptarë, 2 119 serbë, ndërsa të tjerët u përkasin etnive të tjera.

Nga rreth 6 000 njerëzit e zhdukur me forcë atëkohë, të pagjetur sot mbeten edhe më shumë se 1 600 persona. Shumë prej të zhdukurve u gjetën ndër vite nëpër varreza masive në Serbi. Sipas Komisionit Qeveritar të Kosovës për Persona të Pagjetur, gjatë vitit 2023 u gërmua në 15 lokacione brenda territorit të Kosovës, që ndërlidhen me procesin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur, si dhe në një lokacion në Serbi. "Të zhvarrosura janë mbetjet mortore të njëzet individëve - viktimat të luftës, edhe pse numri i personave të zhvarrosur dhe identiteti i tyre do të përcaktohen pasi të përfundojnë të gjitha ekzaminimet mjekoligjore dhe identifikimi përmes analizës së ADN-së", thuhet në raportin e Komisionit Qeveritar të Kosovës.

Përurohen investimet mbi 5 milionë euro në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Me një investim rrënjësor, që arrin shifrën rreth 5.5 milionë euro, sot u përuroren renovimet në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK. Me këtë rast, i pranishëm ishte kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Pas vizitave të reparteve të transformuara në këtë klinikë, kryeministri Kurti tregoi se nga shuma milionëshe e investimeve, mbi 3 milionë euro janë investime në infrastrukturë dhe pajisje për fertilizimin e asistuar mjekësor IVF, ndërkaq rreth 2.4 milionë euro janë për mjekësinë fetale dhe për amniocentezën.

Në anën tjetër, renovimet, të cilat mbulojnë një hapësirë prej 5 000 metrash katrorë, duke përfshirë edhe korridorët, dhomat e shtretërët, janë investime, të cilat ndikojnë në përmirësimin e kushteve për gratë e vajzat,



paciente aty. "Dikur kanë qenë 7-8 gra në një dhomë, ndërkohë që banja ka qenë vetëm në një skaj të korridorit, e përbashkët. Tash në secilën dhomë janë vetëm dy krevate dhe në secilën dhomë ka

nyje sanitare dhe banjë. Pastërtia është maksimale, cilësia e ajrit është e lartë, ndriçimi është i këndshëm dhe përkushtimi i mjekëve dhe i infermierëve është maksimal", shpjegoi kryeministri

Kurti. Duke i falënderuar të gjithë pjesëmarrësit që kontribuan në këtë transformim, ai u shpreh i lumtur që tashmë nënat lehona e foshnjat kanë klinikë më të

mirë gjinekologjike si asnjëherë më parë. Kryeministri ritheksoi se mbështetja financiare për herë të parë e mbi 55 mijë lehonave dhe mbi 400 mijë fëmijëve të Kosovës paraqet edhe një dëshmi të kompletuar se mirëqenia e nënës dhe fëmijës janë fokus i qeverisë.

Ndërkaq ministri Arben Vitia u shpreh i lumtur që sot po fillojnë punën katër repartet më të rëndësishme të rinovuara në Klinikën e Gjinekologjisë. Ai shtoi se tani në këto reparte janë instaluar edhe njësitë e tjera, të cilat do të ndihmojnë në sistemin informativ shëndetësor, derisa do të ketë digjitalizim të radhëve e procese të digjitalizuara dhe gjithë kjo përmes kushteve të jashtëzakonshme që tani e tutje do t'i kenë gratë në këtë klinikë.

Në Klinikën e Gjinekologjisë kryeministri Kurti u mirëpriti nga drejtori i QKUK-së, Osman Hajdaraj, drejtori i Gjinekologjisë, Zef Ndrejaj, drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, Ardian Shefkju, dhe personeli shëndetësor.

BERZh-i investoi mbi 800 milionë euro në Kosovë

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Përfaqësuesit e Bordit të Drejtorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) do ta vizitojnë Malin e Zi nga 17 deri më 18 qershor dhe Kosovën nga 19 deri më 21 qershor. Bëhet me dije se të dy vizitat janë pjesë e një serie të rregullt konsultimesh dhe do t'ua japin përfaqësuesve të aksionarëve mundësinë për të takuar zyrtarë të lartë qeveritarë dhe

anëtarë të komunitetit të biznesit si dhe përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë dhe organizatave të shoqërisë civile. Ata do të vizitojnë edhe projekte private dhe publike të financuara nga Banka në të gjithë Malin e Zi dhe Kosovën.

Përfaqësuesit e BERZh-it do të takohen me presidentin e Malit të Zi, Jakov Milatović, kryeministrin e Malit të Zi, Milojkko Spajiq dhe ministrin

e Financave dhe guvernatorin e BERZh-it, Novica Vuković. Në Kosovë, përfaqësuesit e BERZh-it do të takohen me presidenten Vjosa Osmani, Ahmet Ismailin, guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe disa ministra.

BERZh-i ka investuar 664 milionë euro përmes 109 projekteve në Kosovë që kur iu bashkua bankës në vitin 2012.



Ndërkaq Mali i Zi iu bashkua këtij institucioni financiar në qershor të 2006-s dhe që

atëherë banka ka investuar 804 milionë euro në vend përmes 86 projekteve.

ShBA-ja shqyrton një kuadër të ri ligjor për monedhat digjitale

WASHINGTON, 18 QERSHOR - Mungesa e ligjeve për monedhat digjitale e ka ngadalësuar përhapien e tyre në Shtetet e Bashkuara. Korrespondentja e "Zërit të Amerikës", Deana Mitchell, njofton se shqyrtimi i një kuadri të ri ligjor nga Dhoma e Përfaqësuesve i ka inkurajuar investitorët e tregut të monedhave digjitale.

Sulmet kibernetike në vitet e fundit shkaktuan humbje të mëdha për investitorët e tregut të kriptovalutave, duke ndikuar te rënia e vlerës së tyre. Ekspertët thonë se vlera e monedhave digjitale po rritet përsëri, pjesërisht falë përpjekjeve të Kongresit për ta rregulluar këtë treg. "Flitet shumë për mungesën e qartësisë ligjore për trajtimin e tregut të monedhave digjitale. Kjo është shtysa për këtë legjislacion", thotë ligjvënësi republikan, French Hill. Ligjvënësi i Karolinës së Veriut,



Patrick McHenry, thotë se Ligji për Novacionin dhe Teknologjinë Financiare për Shekullin 21, shkurtimisht FIT21, do të sigurojë që Shtetet e Bashkuara të mbeten një udhëheqës global në fushën e novacionit dhe përshtatjes teknologjike. "Në thelb, ky

legjislacion aplikon mbrojtjen e testuar prej kohësh të konsumatorëve, për të siguruar që 20 % e amerikanëve që investojnë në tregun e monedhave digjitale mund ta bëjnë këtë në mënyrë të sigurt dhe që më shumë amerikanë të angazhohen në këtë treg".

Matthew Graham është partner në firmën "Ryze Labs". Në një konferencë për kriptomonedhat të mbajtur kohët e fundit në Teksas, ai tha se Shtetet e Bashkuara kanë mbetur pas botës kur flitet për monedhat digjitale dhe nuk duhet supozuar se standardi për shumicën e monedhave elektronike do të vazhdojë të jetë dollari amerikan. "Nëse hegjemonia e dollarit amerikan vërtet shihet si një interes kombëtar jashtëzakonisht i rëndësishëm, atëherë kjo është një arsye shumë e fortë për t'i dyfishuar përpjekjet në tregun e monedhave digjitale. Nëse ka diçka që është e mirë për të ardhmen e hegjemonisë së dollarit amerikan, është një kategori alternative ose aset financiar që varet tërësisht te dollari amerikan". Ndërsa vazhdon fushata për Shtëpinë e Bardhë, në treg kanë dalë monedha digjitale që mbajnë

emrin, por nuk kanë lidhje me presidentin Joe Biden dhe kandidatit republikan Donald Trump.

Kandidati për president, Robert Kennedy Jr., mori pjesë në konferencën për kriptovalutën në Teksas, ku mbështetësi i tij dhe shefi i kompanisë "American Crypto Academy", Jahon Jamali, paraqiti monedhën e re digjitale \$BOBBY. "Ajo që kemi parë gjatë viteve të fundit janë ato që quhen 'monedha meme' që përkthehen nga kriptonë një lloj lëvizjeje, kryesisht tani që në Shtetet e Bashkuara është një vit zgjedhor".

Nëse Senati nuk e shqyrton këtë vit zgjedhor legjislacionin e Dhomës së Përfaqësuesve për monedhën digjitale, atëherë mund të jetë në dorën e presidentit të ardhshëm që të punojë për të ardhmen e monedhave digjitale në Shtetet e Bashkuara.

ATK-ja thotë se taksitë duhet të pajisen me sistem fiskal të veçantë

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Administrata Tatimore e Kosovës ka bërë me dije se të gjithë tatimpaguesit të cilët zhvillojnë aktivitet të taksive janë të obliguar të pajisen me Sistem Fiskal të veçantë për Taxi.

Administrata Tatimore e Kosovës tanimë ka certifikuar model të Sistemit Fiskal për sektorë të veçantë Taxi, kështu që personat të cilët zhvillojnë aktivitet të taksive tani mund të pajisen me



Sistem Fiskal të veçantë për Taxi. "Kërkojmë nga të gjithë

tatimpaguesit të cilët ushtrojnë veprimtarinë Taxi, pra ofrojnë shërbime taksi për pasagjerë, që të fiskalizohen sa më parë me Sistem Fiskal të veçantë për Taxi, ashtu siç kërkohet me legjislacionin në fuqi, si dhe Kërkesat Specifike Teknike dhe Funksionale për Pajisjet Elektronike Fiskale/Sistemet Fiskale (PEF/SF). Për t'u fiskalizuar me Sistem Fiskal të veçantë për Taxi është e nevojshme që të

kontaktohen Operatorët Ekonomik të cilët kanë të certifikuar modele të Sistemit Fiskal për sektorë të veçantë Taxi", ka njoftuar ATK-ja. Aktivitetet e ATK-së, ndër të tjera, do të përqendrohen te tatimpaguesit, të cilët kërkohet të fiskalizohen me Sistem Fiskal të veçantë për Taxi, por që ende nuk janë fiskalizuar me këtë Sistemin Fiskal të veçantë; dhe janë të pajisur me Sistemin Fiskal të

veçantë për Taxi, por nuk lëshojnë kupon fiskal. "Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore", ka njoftuar ATK-ja.

Kosova përmes linjës hekurudhore Durrës - Prishtinë bëhet pjesë e një rrjeti regional

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturs, Liburn Aliu, ka folur për projektin e hekurudhës Prishtinë - Durrës, derisa ka dhënë më shumë hollësi për përfitimet që do të ketë Kosova nga ky projekt madhor ndërshqiptar. Ministri Aliu në një intervistë për "KosovaPress" ka treguar si po realizohen projektet

infrastrukturore për zgjerimin e rrugës Prishtinë - Podujevë, projektin për Bujanoc dhe rrugën tjetër për Pejë. Ai thotë se projekti për hekurudhën Prishtinë - Durrës e shndërron Kosovën në një vend kryesor të transitit dhe një pikë shpërndarëse të mallrave.

"Kosova përmes linjës Durrës - Prishtinë bëhet pjesë e një rrjeti regional, aktualisht



është jashtë korridoreve. Pra, të gjithë transporti i mallrave për gjithë regjionin, qoftë në drejtim të porteve, qoftë nga portat në drejtim të regjionit, arrin të bëhet përmes Kosovës", ka thënë ai.

Ministri Aliu shprehet se janë duke punuar të përfundojë çështja e fizibilitetit në mënyrë që të realizohet sa më shpejt projekti për hekurudhën Prishtinë - Durrës.

Vdiq si hero duke luftuar nazistët, por aktivistët e “zgjimit” duan të varrosin emrin e tij

Nga: Simon HEFFER
(The Daily Telegraph)

Dikush kishte shprehur të drekonte në restorantin Tate Britain dhe të studioje muralin e mrekullueshëm të vitit 1927 të Rex Whistlerit, Ekspedita në kërkim të mishit të rrallë [The Expedition in Pursuit of Rare Meats]. Whistleri sapo kishte mbaruar Shkollën Slejd të Artit dhe ishte vetëm 21 vjeç kur e nisi këtë fantazi, duke ua treguar njerëzve rreth të njëjtës moshë artistin që po kalon nëpër një peizazh imagjinar në kërkim të ushqimit. Një pjesë e mirë e muralit është romantizim i thjeshtë, në kundërshtim me modernizmin e kohës kur u pikturua.

Megjithatë, tani pretendohet se ta admirosh veprën kjo është punë raciste. Në vitin 2020, një protestë e orkestruar nga dy gra

të cilat e quanin veten në mënyrë të çuditshme si Qimet e bardha [The White Pube], tërhoqi vëmendjen për një fëmijë me ngjyrë të rrëmbyer që tërhoq me një tojë nga një grua e re tekta nëna e tij shikonte nga një pemë, ndërsa karikaturonte po ashtu popullin kinez.

Dukej se askush nuk dinte – ose nuk donte të dinte – për motivimet e artistit. Whistleri nuk ishte racist, por ishte i njohur për zgjuarsinë e mprehtë. Ishte shumë i vetëdijshëm për pabarazitë tronditëse që qëndronin poshtë shoqërisë së lartë të pamend të viteve 1920 dhe ato qartë i satirizonte në pikturën e vet, ashtu siç do të bënte Evelyn Waugh në romanet e veta.

Arti i Whistlerit u ofendua deri në pikën ku, në vitin 2022, Tate e mbylli dhomën në mënyrë që publiku të mos mund ta shihte. Galeria është ndërtesë e renditur



në Klasin I dhe, pavarësisht nëse i pëlqen apo jo, nuk mund ta heq këtë komponent të strukturës. Megjithatë, në mars u përpoq të “kontekstualizojë” muralin duke e plotësuar me një film që pretendon të eksplorojë “kontekstin social dhe politik të Britanisë së viteve 1920”.

Gjithë kjo është bërë çështje tipike: njerëzit kreativë nga e kaluara vendosen në bankën e të akuzuarve të një gjykate në një vend të cilin nuk e njohin dhe gjykojnë për “veprat” të cilat në atë kohë nuk ishin aspak të tilla. Kjo i bën disa të ndihen sot më mirë, por është krejtësisht johistorike. Çuditërisht, në raportimin e krijimit të filmit të ri, BBC e përshkroi muralin si

“fyes”, por unë nuk e vendos atë epitet në thonjëza: e kishte bërë të veten dhe kishte hedhur poshtë çdo copëz objektiviteti. Muajin e ardhshëm, më 18 korrik, është 80-vjetori i vdekjes së Whistlerit, i vrarë në luftë, në Normandi. Pavarësisht se ishte në mesin e të tridhjetave kur shpërtheu lufta, u caktua në Divizionin e Blinduar të Gardës, sepse aq i vendosur ishte për të luftuar racistët të cilët atëherë e mbanin të pushtuar pjesën më të madhe të Evropës. U vra pasi la tankun e vet për të shkuar në ndihmë të njerëzve të tjerë në njësinë e tij; me sa duket, The Times mori më shumë letra për vrasjen e tij sesa për cilëndo viktimë tjetër lufte. Kjo ose e

tregon shkallën e mbështetjes për një racist, ose thjesht se sa shumë i admiruar ishte ai artist. Muzeu Salisbury në Uiltshir, ka hapur së fundmi ekspozitën e titulluar Rex Whistler: The Artist and His Patrons, e cila do të zgjasë deri më 29 shtator. Ajo merr pamje më të nuancuar dhe më pak hysterike për muralin. “Duhet të jemi të kujdesshëm ndaj censurimit ose shkatërrimit të artit që nuk përputhet me vlerat tona të shekullit XXI”, thotë drejtori i muzeut, Adrian Green – dhe sigurisht që ka të drejtë. Të tjerët të cilët duan të shfaqin vetëm drejtësinë e tyre ndaj vetvetes, duhet të ndalojnë së treguari këtë. /Telegrafi/



Detaje nga vepra e censuruar e Whistlerit

Gajdexhiu i Normandisë



Nga: Dashnor KOKONOZI

Siç pritej, 80 vjetori i zbkimit në Normandi, i cili cilësohet si më i madhi i historisë së njerëzimit, sollti në kujtesë të njerëzve mjaft ngjarje të asaj ditë të paharruar. Në mendje më mbeti historia e një ushtari skocez. E Bill Millinit i cili midis shpërthimit të bombave, predhave të artilerisë, snajperëve e bataveve të mitralozave gjermane që fortifikonin atë që quhej “Muri i Atlantikut), nisi të luajë me gajde himnin e regjimenteve skocezë, Djaloshi i Malësisë [Highland Laddie].

Tek po zbriste nga blindi amfib dhe po i afrohej bregut, në vend të armës Bill Millini bëri gati gajden e vet, madje veshi edhe kiltin skocez që kishte mbajtur i ati në Luftën e Parë Botërore. Një oficeri që i thotë se rregullat e ushtrisë angleze nuk lejojnë përdorimin e gajdes në luftë, Bill Millini i përgjigjet se ai ishte skocez.

Hodhi pushkën krahëqafë dhe

nisi t'i bjerë gajdes mu aty ku ra në uj; (madje iu lag edhe gajda dhe notat e para nuk ishin fort t; mira). Pas hutimit të parë, të shtënat filluan nga përsëri duke masakruar e përgjysmuar forcat aleate që nuk kishin ku të mbroheshin.

Rreth 20 vetë nga të kompanisë së Billit u vranë mu pranë tij. Deti u skuq dhe atij do t'i kujtohet deri në fund të jetës se si eci i përskuqur deri në brez nga gjaku i vëllezërve të tij të armëve.

Arsyeja përse u vranë thuhet të gjithë ata që ishin me të dhe ai jo, do të merret vesh më vonë. Ishte një snajperist gjerman, nga ata që do të zihen robër, i cili tregoi më pas se ai e kishte vënë disa herë në shënjestër Bill Millinin, por nuk kishte qëlluar sepse e kishte marrë për të çmendur ... Pas luftës, Bill Millin do të jetë pjesë e gajdexhive të gardës mbretërore.

Vdiq më 2010, por jo pa e dorëzuar gajden e tij në një muze të luftës, që ia kishte kërkuar. Thuhet se sot e kësaj dite ajo ka brenda frymën e tij ...

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Inveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT
EURO2024 GERMANY



Sot tri ndeshje në 'Euro 2024', Shqipëria përballet me Kroacinë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

GELSENKIRCHEN, 18 QERSHOR - Kampionati Evropian "Euro 2024" sot (e mërkurë) sjellë tri ndeshje shumë interesante. Shqiptarët do të jenë të përqendruar te ndeshja e orës 15:00, pasi Kombëtarja e Shqipërisë do të përballet me Kroacinë në kuadër të Grupit B. Të dyja këto kombëtare e nisën keq aventurën në "Euro 2024", pasi pësuan humbje nga Italia, përkatësisht Spanja dhe tash si Shqipëria ashtu edhe Kroacia do ta kërkojnë fitoren e parë në Evropian. Mbrojtësi i Shqipërisë, Mario Mitaj, ka thënë se Kroacia është një kundërshtar shumë e fortë, por se kuqezinjët kanë synime të mëdha në këtë ndeshje. "I dimë cilësitë që ka Kroacia dhe sa e fortë është. Kroacia i ka të gjitha repartet

cilësore, sidomos mbrojtjen dhe mendoj se ajo do të jetë pika më e fortë e kësaj ndeshjeje. Pavarësisht humbjes, atmosfera nuk ndryshoi. Jemi shumë harmonikë si ekip. Në fund të fundit jemi në Kampionatin Evropian dhe duhet ta shijojmë në maksimum. E kemi respektuar shumë kundërshtarin. Donim të merrim diçka më tepër nga ajo ndeshje, por në ndeshjen me Kroacinë do të futemi për të marrë më shumë se në sfidën e parë dhe, pse jo, të arrijmë një arritje historike. Ngarkesa psikologjike nuk ndikon shumë. Jemi 11 kundër 11. Në fushë le të fitojë më i mirë", ka deklaruar Mitaj. Edhe në këtë ndeshje pritet të jenë në stadium një numër i tifozëve shqiptarë për ta përkrahur kombëtaren e zezërës. Për ndeshjen ndaj Shqipërisë ka folur edhe sulmuesi i Kroacisë, Andrej Kramariq. Ky i fundit ka deklaruar



se kroatët janë të fokusuar maksimalisht dhe kërkojnë fitore në ndeshjen ndaj Shqipërisë. "Nuk kemi menduar se sa pikë do të na duhen për kualifikim. As nuk kemi pasur kohë për të menduar për këtë. Ndeshja më e rëndësishme është ajo e radhës dhe për ne, më e rëndësishmja është ajo ndaj

Shqipërisë. Kërkojmë fitoren, duke e thënë qartë dhe shkurt. Nuk mund të llogarisim asgjë tjetër. Nga ne priten tri pikë nga kjo ndeshje. Kjo është kryesore. Më pas do të mendojmë për Italinë, por për momentin përqendrim maksimal te Shqipëria", ka deklaruar Kramariq.

GRUPI A
18:00 GJERMANI - HUNGARI
21:00 SKOCI - ZVICRA
GRUPI B
15:00 KROACI - SHQIPËRI

Nga ora 18:00 zhvillohet ndeshja në mes të Gjermanisë dhe Hungarisë, nga ku gjermanët presin fitoren e dytë dhe sigurimin e kualifikimit tutje. Në anën tjetër hungarezët, pas humbjes në ndeshjen e parë nga Zvicra, do të mundohen të shkaktojnë befasi ndaj nikoqirëve të Evropianit. Në orën 21:00 Zvicra e shqiptarëve do të përballet me Skocinë dhe në këtë ndeshje kanë synim që të marrin tri pikë dhe ta sigurojnë kualifikimin, derisa skocezët do të mundohen të nxjerrin rezultat pozitiv.

Prizreni organizon festivalin më të madh të çiklizmit në Kosovë



PRIZREN, 18 QERSHOR - Bike Fest Prizren, festivali më i madh i çiklizmit në Kosovë, do të mbahet këtë fundjavë nga data 21 deri më 23 qershor në qytetin e Prizrenit. Ky festival synon ta promovojë çiklizmin si një kulturë dhe mënyrë jetese të shëndetshme, ta nxisë sportin dhe rekreacionin dhe të ofrojë argëtim për të gjithë pjesëmarrësit. Ngjarja do të fillojë me hapjen e festivalit më 23 qershor, e cila do të shoqërohet me një tur simbolik me biçikleta nën

moton "Pedalo me pasion, festo me Bikefest" nga Sheshin e Dëshmorëve duke filluar nga ora 12.00 ku ftohen të marrin pjesë të rinjtë, të moshuarit, fëmijët, gratë dhe burrat për të shijuar një tur të këndshëm përreth unazës së qytetit. Në kuadër të festivalit aktivitetet kryesore përfshijnë: Ligjërata nga profesionistët për shëndetin fizik dhe ushqimin e duhur për sportistët. Konferencë nga kryetari i Federatës së Çiklizmit të Kosovës për zhvillimet

e fundit në fushën e çiklizmit në Kosovë. Gara "XC Pashaqeshme Prizren": Një garë sfiduese çiklizmi me distancë 18.75 km mes natyrës dhe trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Pjesëmarrësit do të kalojnë përmes peizazheve të bukura dhe rrugëve malore që përfundojnë në Sheshin e Dëshmorëve. Bike Fest Prizren 2024 është mbështetur nga komuna e Prizrenit dhe sponsorë të tjerë të cilët kanë ndihmuar në realizimin e këtij projekti.

Ballkani fat në short në Ligën e Kampionëve, Llapi me kundërshtar të vështirë në Ligën e Evropës

SUHAREKË, 18 QERSHOR - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Ballkani, e ka mësuar emrin e skuadrës kundërshtare në rrethin e parë të kualifikimeve për Ligën e Kampionëve. Klubi që drejtohet nga Ilir Daja ka qenë me fat në short. Fillimisht ka shmangur përballjen me skuadrat shqiptare si Struga, Egnatia dhe Deçiq. Suharekasit në rrethin e parë do të përballet

me UE Santa Coloma, skuadrën kampione në fuqi të Andorrës. Ndeshja e parë do të luhet në Kosovë, kurse ajo e kthimit në Andorra. Egnatia do të përballet me Borac Banja Luka, me sfidën e parë që do të luhet në udhëtim dhe e kthimit në Shqipëri. Short i komplikuar për Strugën, që do t'i gjejë përballë sllovakët e Slovan Bratislavës, me sfidën e parë që do të luhet në transfertë



dhe të kthimit në Maqedoninë e veriut. Skuadra tjetër shqiptare, kampionja e Malit të Zi, Deçiq Tuzi, gjeti përballë uellsianët e The New Saintsit. Ndeshjet e para të turit të parë eliminator do të zhvillohen më 9 dhe 10 korrik, ndërsa ato të kthimit një javë më vonë, më 16 dhe 17 korrik. Nënkampioni i Kosovës, Llapi, e ka mësuar kundërshtarin e parë

në kualifikimet e Ligës së Evropës. Skuadra e drejtuar do të përballet me skuadrën polake, Wisla Krakow. Takimi i parë do të luhet në Kosovë, derisa i kthimit do të zhvillohet në Poloni. Ndeshja e parë mes dy ekipeve do të luhet më 11 korrik, e dyta më 18 korrik. Fituesi i përballjes luan në rrethin e dytë kualifikues të këtij kompeticioni.

Ferizaj 'blindon' Haxhimusën dhe Jovanovskin

FERIZAJ, 18 QERSHOR - Skuadra e Ferizajt, që sezonin e ri do të jetë pjesë e Superligës në futboll, ka 'blinduar' me kontrata të reja dy futbollistë. Fjala është për sulmuesin Betim Haxhimusa dhe

portierin Marko Jovanovski. "Kemi kënaqësi t'ju njoftojmë se sulmuesi Betim Haxhimusa ka nënshkruar vazhdimin e kontratës me klubin tonë. Haxhimusa ishte një prej më meritoreve për suksesin e

arritur në Ligën e Parë përmes golave vendimtarë. Sukseset dhe golat mos mungofshin as në Superligë, Betim Haxhimusa", thuhet në njoftimin e Ferizajt. "Dorëza e artë, Marko

Jovanovski konfirmohet si pjesë e skuadrës edhe për edicionin 2024/2025. Ne jemi të lumtur që bashkëpunimi me Markon, si një portier profesional, do të vazhdojë edhe në Superligë", thuhet në këtë njoftim.



Papuqi emërohet trajner i FC Dardania

PEJË, 18 QERSHOR - FC Dardania ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me trajnerin Fisnik Papuqi për ta marrë drejtimin e skuadrës. Fisnik Papuqi është shpallur katër herë kampion i Kosovës dhe pesë herë fitues i Kupës.

Mbrojtësi nga Peja ka luajtur edhe në Shqipëri e Mal të Zi. Profesionin e trajnerit e ka nisur te moshat e KF Besës, klubit të tij të zemrës, duke vazhduar edhe si kryetrajner i ekipit të parë, për të vazhduar me KF Rilindja 1974 në Ligën

e Parë si dhe me vonë edhe me KF Deçani. "Timonieri nga Peja do ta drejtojë skuadrën tonë drejt të vetmit synim, inkuadrimit në ligën e parë. Kryesia e klubit ishte e pajtimit që t'i japë besimin trajnerit Papuqi për

udhëheqjen e skuadrës. U betuan se do të qëndrojnë afër me kushtet dhe të gjitha mundësitë që klubi ynë ta arrijë qëllimin që e ka për këtë sezon. Na priftë e mbara!", thuhet në njoftimin e FC Dardania.



Fury, mesazh tifozëve dhe Usykut: Më 21 dhjetor mbreti do ta rimarrë fronin e tij

LONDËR, 18 QERSHOR - Boksieri britanik Tyson Fury ka mohuar zërat se revanshi i tij me Oleksandr Usyk mund të jetë në rrezik. Ai ka shpërndarë një video në rrjetet sociale, ku është duke u stërvitur në palestër. Ai shprehet se është gati për sfidën e dytë ndaj ukrainasit, e planifikuar të zhvillohet në dhjetor të këtij viti. Në sfidën e një muaji më parë në Riad, Usyk mundi Fury me vendim shumice, për t'u bërë kampioni i parë i padiskutueshëm i botës në peshën e rënda që nga koha e Lennox Leëis (1999). Pas duelit, Fury vendosi ta aktivizojë klauzolën e tyre të revanshit, siç ishte nënshkruar në kontratë. Tifozët ishin të shqetësuar se revanshi mes Furyt dhe Usykut do të anulohet pasi u shfaqën pamjet e Gypsy Kingut duke u shoqëruar nga një lokal në Morecambe javën e kaluar. Fury ka hedhur poshtë pretendimet se ai po dilte jashtë kontrollit duke shpërndarë një



video të tij në stërvitjen e palestrës për sfidën e kthimit. Fury postoi një video duke goditur çantën me rërë me mbishkrimin e mëposhtëm: "Më 21 dhjetor, në Riad, në zemër të mbretërisë, mbreti do ta rimarrë fronin e tij dhe do të bëhet i padiskutueshëm". "Usyk, po vij për ty! Bëhuni gati për 'Mbretin Cigan!' Rruga drejt shpengimit është e gjitha e imja. Unë e di se çfarë duhet të bëj. I pashë mangësitë e mia dhe më së

miri besoj se jam kampion", tha më tej boksieri britanik. Gjatë videos, Fury u dëgjua duke thënë: "Hej djema, Tyson Fury këtu. Unë jam kthyer në palestër siç mund ta shihni. Po numëroj ditët derisa të mund ta marr shpengimin tim në Usyk. 21 dhjetori do të jetë koha ime. Unë kam bërë gjithçka në boks, por nuk jam kthyer nga një humbje. Por, më pëlqen. Mundësia për t'u kthyer dhe për ta shpenguar veten. 21 dhjetor, jam e gjitha unë".

Boston Celticsi shpallet kampion në NBA

BOSTON, 18 QERSHOR - Ekipi i Boston Celticsit është shpallur kampion i NBA-s pas fitores 106-88 ndaj Dallas Mavericksit në finalen e pestë "play-off", duke fituar 4-1 serinë e finaleve. Ky është titulli i 18-të në histori për ekipin e Bostonit, që bëhet kështu skuadra me më shumë tituj kampionë, një më shumë se Lakersat (17). Basketbollisti Jaylen Brown u shpall MVP i finaleve, një lojtar që ka qenë lider për Bostonin këtë sezon, duke e merituar trofeun. Për sa i përket takimit të fundit, ai u dominua e fitua me meritë nga Bostoni, që para publikut nuk zhgënjeu, duke triumfuar e duke festuar bashkë me tifozët. Luka Donçiqi realizoi 28 pikë e 12 rebounde për Dallasin, por nuk u mbështet sa duhet nga pjesa tjetër e skuadrës. Për Bostonin, shënuesi më i mirë sot



ishte Jayson Tatum me 31 pikë, ndërsa Brown realizoi 21 pikë. Gjithsesi, ky i fundit ka qenë i jashtëzakonshëm përgjatë gjithë sezonit. Një sezon që Bostoni e dominoi dhe fitoi me meritë, pasi

ishte skuadra me rekordin më të mirë në sezonin e rregullt. Kjo u pa qartë edhe në këtë finale, që nuk pati histori, me Celticsin që ngriti lart trofeun dhe festoi me meritë titullin kampion.

SHKURT

Mbappe shmang operimin, do të luajë me maskë

Kylian Mbappe në ndeshjen ku Franca fitoi ndaj Austrisë theu hundën dhe u gjakos pas një dyluftimi në zonë. Teksa mendohej se lojtari do të operohej, e kundërta do të ndodhë. Sipas njoftimit nga Federata Franceze e Futbollit, Mbappe nuk do t'i nënshtrohet një ndërhyrjeje kirurgjikale, por do të vendosë një maskë dhe do të jetë në ndeshjet e ardhshme të Francës. "Kylian ka pësuar një frakturë në hundë. Është rikthyer në kampin bazë të skuadrës franceze. Do t'i marrë trajtimet e duhura, por nuk do të operohet menjëherë, do t'i vendoset një maskë për t'ia dhënë mundësinë që të zbresë në fushë", thuhet në reagimin e Federatës Franceze.

Përfundon Evropiani për Vlasiqin

Lojtari i Kombëtares së Kroacisë, Nikola Vlasiq, do të largohet nga kampi i kombëtares dhe do të humbasë pjesën tjetër të Kampionatit Evropian në Gjermani për shkak të një dëmtimi muskolor. Federata Kroate e Futbollit ka njoftuar se 26-vjeçari ka humbur pjesën tjetër të "Euro 2024" shkak i lëndimit. "Vlasiq ka pësuar lëndim gjatë stërvitjes dhe sot iu nënshtrua një ekzaminimi me rezonancë magnetike me doktorin Sasha Janković, i cili zbuloi një këputje të lehtë të muskujve. Trajneri Zlatko Daliq, në marrëveshje me Vlasiqin dhe shërbimin mjekësor, ka marrë vendim që Nikola të largohet nga kampi i Kombëtares, pasi lëndimi i tij nuk e lejon të garojë për ndeshjet e Euros", thuhet në njoftimin zyrtar të HNS. Vlasiq ka luajtur deri tani 56 ndeshje për Kroacinë, në të cilat shënoi tetë dhe asistoi tri herë. Në Kupën e Botës "Katar 2022", ai luajti në gjashtë nga shtatë ndeshjet.

Joao Felix kërkon të qëndrojë te Barça

Anëtori portugez Joao Felix duket se do të qëndrojë në "Camp Nou" teksa, sipas raportimeve të medieve spanjolle, 24-vjeçari spanjoll do të qëndrojë edhe për të paktën një sezon te Barcelona, ku pritet të jetë sërish në huazim. Vetë menaxheri i yllit portugez Jorge Mendes është në krye të operacionit i cili, në këtë pikë, është duke u ecur shumë mirë. Mungojnë vetëm disa detaje përpara se të mbyllet përfundimisht, teksa në medie është raportuar gjithashtu se "Los Colchoneros" e Atletico Madridi u propozoi "katalanasve" që të blinte një përqindje të kartonit të "fantazistit" të sulmit, por nuk pati marrëveshje. Joao Felix është kthyer në një lojtar të rëndësishëm për spanjollët, teksa ka arritur të zbresë në fushë plot 44 herë, ku ka mundur të dërgojë plot 10 herë topin në rrjetë, si dhe të asistojë në 6 raste të tjera, shokët e tij të skuadrës.

Premierë Liga fillon me derbin Chelsea - City

Kur jemi në ditët e zjarra të evropianit, Premierë Liga, e cila do ta nisë sezonin e ri më 16 gusht, ka publikuar edhe kalendarin për sezonin e ri, ku spikat që në javën e parë, sfida mes Chelsea dhe kampionit në fuqi, Manchester City. Java e parë: Manchester United-Fulham, Ipswich Town-Liverpool, Arsenal-Wolves, Everton-Brighton, Newcastle United-Southampton, Nottingham Forest-Bournemouth, West Ham-Aston Villa, Brentford-Crystal Palace, Chelsea-Manchester City, Leicester City-Tottenham.

Leclerc: Kemi shanse për t'i fituar të dy titujt e sezonit

Sezoni 2024 në Formula 1 është natyrisht më i mirë për Ferrarin, që ka arritur dy fitore, një me Carlos Sainzin dhe një me Charles Leclercin. Ky i fundit është në vendin e dytë për pilotë, me 56 pikë pas kampionit të botës Max

Verstappen. Gjithsesi, monmogasku beson se ka ende shanse të shpallet kampion bote këtë vit, sidomos në botërorin për konstruktorë. Një deklaratë që vjen pas garës zhgënjyese që "kokëkuqja" bëri në Kanada, ku nuk mori asnjë

pikë me pilotët e saj. Leclerc vazhdon të besojë se mund të luftojë për ta fituar titullin: "Ne kemi një shans mes konstruktorëve, por edhe në atë mes pilotëve do të shtyj në maksimumin tim deri në fund të sezonit. Nuk tërhiqem

kollaj, pasi sezoni është i gjatë". "Fitimi i Kampionatit Botëror dhe ta bëj atë me Ferrarin është qëllimi i jetës sime. Sa kohë jam i gatshëm të pres? Sa kohë që duhet. Kjo është skuadra që më ka bërë të ëndërroj si fëmijë dhe që ka

besuar tek unë kur kam qenë i vogël. Do të bëj gjithçka që kjo të ndodhë sa më shpejt", ka shtuar Leclerc. Gara e radhës në Formula 1 është këtë fundjavë në Spanjë, ku "kokëkuqja" synon të rikthehet pretendente në pistë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

